

**VENDIM**  
**Nr. 387, datë 28.12.2023**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALPIQ ENERGY ALBANIA” SHPK PËR  
HEQJEN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, germa “dh” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, germa “dh”, 7, paragrafi 2 dhe nenit 9, germa “d” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 5.1, germa “dh” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1450/3 prot., datë 22.12.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Alpiq Energy Albania’ sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 290, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015, rinovuar me vendimin nr. 81, datë 4.5.2020, për një afat 5-vjeçar (deri më 4.5.2025).

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 14.11.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e kësaj licence, për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2023 dhe nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim me shkresën nr. 1450/2 prot., datë 21.11.2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2500 prot., datë 13.12.2023, shoqëria ka paraqitur kërkesën për heqjen e kësaj licence, pasi ka vendosur mbylljen e veprimtarisë dhe nisjen e procedurave të likuidimit, duke marrë angazhimin për të shlyer sa më shpejt pagesën rregullatore.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (*statement*) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 14.12.2023, ndaj ajo nuk rezulton më debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit.

- Në nenin 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në nenin 5, germa “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 5.1, germa “dh” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, përcaktohet se: *ERE heq një licencë me kërkesë të të licencuarit.*

- Në nenin 7, paragrafi 2 i rregullores së sipërcituar përcaktohet se: *në rast se i licencuari është propozuar për t’iu hequr licenca për shkak të kushteve të parashikuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, ERE do të procedojë menjëherë me zbatimin e parashikimeve të nenit 9 të kësaj rregulloreje, ndërsa në nenin 9, germa “d” të kësaj rregulloreje parashikohet, se ...Bordi do të vendosë për të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “dh” dhe/ose “e” të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në përputhje me nenin 7, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje.*

- Duke qenë se tashmë ndryshojnë rrethanat/shkaqet për të cilat u mor vendimi i Bordit nr. 342/2023, vlerësohet të vijohet me procedurën e heqjes së licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por duke miratuar kërkesën e saj për heqjen e kësaj licence, sipas përcaktimeve ligjore si më lart cituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës nr. 290, seria T15/T20, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.5.2015, rinovuar me vendimin nr. 81, datë 4.5.2020.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar e humbet fuqinë juridike.

3. Grupi i Punës të njoftojë shoqërinë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

**Erjola Sadushi**